

Nr. Prot. Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2023  
Nr. Dok. 202300560/2

**Lënda:** *Rekomandim për inspektimin e kryer në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë në Komisariatin e Policisë Sarandë.*

**Drejtuar:** **Z. Ermal MUÇAJ**  
**Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë**

**VLORE**

**Z. Gerald TOSKA**  
**Shef i Komisariatit të Policisë Sarandë**

**SARANDË**

**Për dijeni:** **Drejtues Madhor Muhamet RRUMBULLAKU**  
**Drejtor i Përgjithshëm i Policisë të Shtetit**

**TIRANË**

*Të nderuar,*

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm dhe duke vlerësuar angazhimin dhe punën e të gjithë stafit të institucionit që ju drejtoni, si dhe frymën e mirë të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis institucioneve tona, në vijim po ju njohim mbi inspektimin e paparalajmëruar që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në Komisariatin e Policisë Sarandë.

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 të ligjit nr. 81/2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në datën 08.06.2023 në ambientet e privimit të lirisë të personit në Komisariatin e Policisë Sarandë.

Inspektimi u krye sipas Planit të Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Gloria Çarkaxhiu dhe znj. Nertila Qafzezi me detyrë Nd/komisionere pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, procedurën standarde

*“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, procedurën standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimit të mëparshëm.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, ka detyrimin ligjor t’ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, si më poshtë vijon:

### **Shënime të përgjithshme**

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas që iu është privuar liria, grupi i punës në mungesë të shefit të komisariatit u takua me shefin e rendit dhe sigurisë publike z.Andi Duro dhe shefin dhomave të sigurisë z. Kastriot Satka në Komisaratin e Policisë Sarandë, të cilët u vunë në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në takim, grupi i inspektimit të MKPT-së u informua mbi masat e marra nga strukturat përgjegjëse në Komisaratin e Policisë në Sarandë për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm.

Gjatë inspektimit na u bë me dije nga drejtuesit e institucionit se kishte filluar zbatimi i projektit *“Rikonstruksioni/Ndërtimi i objekteve të Komisarimit të Policisë Sarandë”* më datë 08.12.2022, i cili parashikohet të zgjasë 18 muaj. Punimet e parashikuara në këtë objekt kanë për synim rikonstruksionin e godinës ekzistuese pasi gjendja aktuale e saj është në kushte jo të mira, me shenja të dukshme lagështie, suvatim i degraduar, dhe ambiente jashtë standardi. Gjithashtu ky projekt synon zgjerimin e hapësirave në këtë komisarim pasi godina ekzistuese nuk ofron të gjithë shërbimet e parashikuara sipas kuadrit rregullator. Vihet re kërkesa për më shumë zyra dhe gjithashtu mungon qasja për personat me aftësi të kufizuara. Rikonstruksioni i objektit vjen si domosdoshmëri në plotësimin e nevojave dhe përmirësimin e standardeve të akomodimit për të krijuar infrastrukturën e nevojshme për ushtrimin e përgjegjësive ligjore të institucionit.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen që të ndiqet me kujdes zbatimi i projektit të rikonstruksionit në mënyrë që godina e rikonstruktuar të jetë tërësisht në përputhje me parashikimet e procedurës standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, si dhe procedurës standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019.

Në vijim, grupi i punës inspektoi ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë, u njoh me regjistrat dhe dokumentacionin ku pasqyrohen të dhënat dhe veprimet e kryera me

personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar, si dhe vizitoi zyrat e punës të punonjësve të policisë të këtij komisariati.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi mëparshëm<sup>1</sup>, rezultoi se:

- **Ishte realizuar** rekomandimi, për marrjen e masave të menjëhershme, për vënien në zbatim të planit të parashikuar që në vitin 2019 për rikonstruksionin e përgjithshëm të godinës së Komisarariatit të Policisë Sarandë.

Ndërkohë, grupi i inspektimit konstatoi se nuk kishin gjetur zbatim por ishin në proces rekomandimet e mëposhtme:

- **Nuk ishte realizuar** rekomandimi, për marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin e ambienteve të reja të sigurisë sipas procedurave standarde: *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1102, datë 07.11. 2017 në Komisarariatit të Policisë Sarandë.
- **Nuk ishte realizuar** plotësisht rekomandimi, për marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin në Komisarariatet e Policisë Sarandë të ambienteve të shoqërimit sipas kriterëve të parashikuara në procedurën standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, duke krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur.
- **Nuk ishte realizuar** rekomandimi, për marrjen e masave të nevojshme për krijimin dhomës (zyrës) më vete në ambientin e sigurisë, për marrjen në pyetje të personave të ndaluar/arrestuar, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera.
- **Nuk ishte realizuar** rekomandimi, për marrjen e masave të nevojshme për krijimin të dhomës (zyrës) në ambientin e shoqërimit, për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera.
- **Nuk ishte realizuar** rekomandimi, për marrjen e masave të menjëhershme për rishikimin e strukturës/organikës së këtij institucioni dhe veçanërisht me shtimin e mjekut, psikologut dhe juristit.
- **Nuk ishte realizuar** rekomandimi, për marrjen e masave për plotësimin me saktësi të regjistrave dhe në veçanti të rubrikës *“Të dhëna për njoftimin e familjarëve/afërmve”* të të shoqëruarit sipas kriterëve të parashikuara në procedurën standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019.

---

<sup>1</sup> Rekomandimi i dërguar me shkresën nr. K4/I56-2 prot., datë 21.10.2022.

Grupi i inspektimit, pasi mori informacionin e nevojshëm lidhur me qëllimin e vizitës inspektuese, vijoi takimin me punonjës të informacionit dhe përgjegjës të dhomave të sigurisë në Komisarariat të Policisë Sarandë, inspektoi kushtet e mjedisit të shoqërimit dhe të sigurisë, vizitoi zyrat e punës të punonjësve të policisë të cilët kryenin veprime procedurale hetimore me personat e shoqëruar, si dhe u njoh e administroi dokumentacionin ku ishin evidentuar të dhënat dhe veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar, gjatë kohës së qëndrimit në mjediset e këtij komisarati.

Theksojmë se, drejtuesit dhe punonjës të policisë të Komisarariatit të Policisë Sarandë me të cilët kontaktoi grupi i inspektimit, u treguan bashkëpunues përgjatë inspektimit që u zhvillua në ambientet e këtij institucioni.

Në përfundim të inspektimit, pavarësisht pak masave administrative që ishin marrë për respektimin e të drejtave ligjore të personave të shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar, në Komisarariat të Policisë Sarandë vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika thelbësore në lidhje me të drejtat e të ndaluarve apo shoqëruarve si më poshtë:

### **Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre**

Ambienti i shoqërimit në Komisarariat të Policisë Sarandë, **nuk** ishte i ndërtuar sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, ku parashikohet se dhomat e shoqërimit duhet të jenë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit.<sup>2</sup>

Grupi i inspektimit konstatoi se ishte vetëm 1 (një) ambient shoqërimi, në formën dhomë-paradhomë. Ky ambient shërbente sipas nevojave, për shoqërimin e personave të rritur dhe grave. Ndriçimi natyral dhe ajrimi në paradhomë ishte i mjaftueshëm, ndërsa në dhomë ndriçimi dhe ajrimi bëhej indirekt nga paradhoma dhe ishte i pamjaftueshëm. Gjithashtu, dhoma dhe paradhoma kishin ndriçim artificial nga rrjeti elektrik, por kishte një mungesë të theksuar të higjienës dhe nuk ishin të lyera. Në fundin e dhomës ndodhej një tualet për plotësimin e nevojave të personave të shoqëruar.

Korridorin e këtij ambienti ishte i monitoruar me sistemin e kamerave, si dhe ishin vendosur postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në gjuhën shqipe ndërsa mungonte posterin me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në gjuhën shqipe brenda dhomës. Posterat duhet të vendosen në vende ku të shoqëruarit apo arrestuarit kanë qasje dhe mund të konsultojnë ato, ndërsa korridoret janë ambiente kalimi që nuk garantojnë qasje efektive të të shoqëruarve me këto të drejta. Ndërsa

---

<sup>2</sup> Kreu VI, pika 3 e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.

për shtetasit e huaj, karta e të drejtave ishte përkthyer në disa nga gjuhët e huaja kryesore.

Pavarësisht rekomandimeve të mëparshme të Avokatit të Popullit, në Komisarariat e Policisë Sarandë ngelet si problematikë, mungesa e dhomave të shoqërimit më vete për femra dhe të miturit.

Nga inspektimi u evidentua se, **nuk** kishte dhomë më vete për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar dhe intervistimi i tyre kryhej në zyrat e punës të punonjësve të policisë. Ndërsa, për intervistimin/marrjen në pyetje të të miturve që shoqëroheshin në mjediset e komisarariatit, ishte krijuar “Njësia për intervistimin e të miturve”, projekt i mbështetur nga UNICEF dhe Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar.

Nga verifikimi i dokumentacionit, u konstatua se, në këtë komisarariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit të çështjes përkatëse. Ky dokument plotësohej në dy kopje, një kopje e të cilit mbahej nga punonjësi i policisë në zyrën e informacionit.

Nga verifikimi i disa praktikave të njëpasnjëshme, u evidentuan se, në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë të Komisarariatit, një kopje e procesverbalit pasi firmosej, i jepej edhe personit të shoqëruar.

Nga inspektimi i ambienteve në mjedisin e shoqërimit, nuk u gjetën sende apo mjete të tilla që mund të shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve të personave apo për kundërveprim ndaj punonjësve të policisë.

Në kohën e inspektimit, nuk kishte persona të shoqëruar në dhomat e shoqërimit të këtij komisaritati. Ndërsa për periudhën Janar - Qershor 2023 në regjistër ishin evidentuar të dhënat për 204 persona të shoqëruar/ndaluar në mjediset e këtij komisaritati.

### **Ambientet e sigurisë, kushtet e tyre dhe trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve**

Në Komisarariat e Policisë Sarandë kishte 2 dhoma sigurie me kapacitet për 3 (tre) persona, të cilat ndodheshin në ambientet e godinës së këtij organi dhe shërbenin për sigurimin e personave të rritur. Gjendja dhomave, lidhur me kushtet fizike të tyre, në ambientin e sigurisë nuk kishte ndryshuar nga inspektimi i fundit i kryer nga Avokati i Popullit. Këto dhoma ishin pajisur me krevate dhe dyshekë. Megjithatë kushtet dhe standardet për mbajtjen, trajtimin, sigurimin e personave që qëndrojnë në këto ambiente, referuar procedurës standarde: “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1102, datë 07.11. 2017.

Nisur nga gjendja teknike ishte evidente lagështira në mure, ndërkohë që dritaret e tyre ishin me përmasa të vogla dhe nuk lejonin futjen e ajrimit dhe të ndriçimit natyral të mjaftueshëm. Në korridorin e ambientit të sigurisë ndodhej një tualet i përbashkët, i cili kishte ujë të rrjedhshëm, por nuk kishte dush me ujë të ngrohtë. Në këtë ambient kishte ndriçim artificial që sigurohej nga rrjeti elektrik. Gjithashtu në ambientin e sigurisë nuk kishte ambient më vete për ajrimin e të arrestuarve/ndaluarve. Gjithsej gjatë vitit 2023 ishin ndaluar 90 persona.

Në tërësinë e tij ambienti i sigurisë plotësonte kriteret dhe kushtet **minimale** për trajtimin dinjitoz të shtetasve të arrestuar dhe të ndaluar, por kishte nevojë për riparime.

### **Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre**

Në zbatim të kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”<sup>3</sup> dhe “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”<sup>4</sup>, parashikohet se çdo njësi policore që ka dhoma shoqërimi dhe sigurie, duhet të jetë e pajisur ndër të tjera edhe me regjistrat përkatës.

Gjatë kontrollit të dokumentacionit, u evidentua se, Komisariati i Policisë Sarandë, mbante regjistrat e përcaktuar sipas inventarit të procedurave standarde me një përjashtim. Ato mbaheshin në dhomën e përgjegjësit të dhomave të sigurisë dhe në zyrën e informacionit. Administrimi dhe plotësimi i tyre kryhej nga punonjësit e policisë të ngarkuar me këtë detyrë.

Nga verifikimi, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr.1” sipas procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, i cili mbahej në zyrën e informacionit dhe ishte i sekretuar e i plotësuar sipas rubrikave.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi e shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Kishte disa raste që në rubrikën “Të dhëna për njoftimin e familjarëve/afërmve” të të shoqëruarit shkruhej vetëm se familja ishte prezent por nuk pasqyroheshin emri i të njoftuarit dhe numri telefonit, pa shënuar gjeneralitetet e plota të personit të njoftuar, lidhja me

<sup>3</sup> Kreu VII, pika 5, parashikuar në Urdhrin Nr. 938, dt. 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shteti “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.

<sup>4</sup> Kreu XI, pika 1, parashikuar në Urdhrin Nr. 938, dt. 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shteti “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.

personin e shoqëruar, si dhe koha e njoftimit.<sup>5</sup> Koha e arrestimit apo ndalimit të të shoqëruarve ishte e njëjtë me kohën e shoqërimit të tyre pranë organit të policisë.

Avokati i Popullit vlerëson se plotësimi i rregullt i regjistrave është element i domosdoshëm i punës së policisë që parandalon abuzimet e mundshme.

Gjithashtu, në këtë komisariat ishte vendosur regjistri për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e policisë së këtij komisariati.

Nga verifikimi i regjistrave ku evidentohen rastet e shoqërimit dhe të arrestimeve/ndalimeve të kryera nga punonjësit e komisariatit të policisë, konstatoam se, zbatohet rekomandimi i Avokatit të Popullit për ndryshimin e praktikës të viteve të kaluar lidhur me orën e arrestimit dhe ndalimit të shtetasve, duke shënuar në procesverbalet e arrestimit apo ndalimit orën faktike kur ata janë shoqëruar për në organin e policisë, pra në orën kur personit është privuar liria dhe jo orën kur përpilohet procesverbali përkatës.

Ndërkohë, në zbatim të kërkesave të nenit 115 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, komisariati **nuk** kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar.

### **Ambientet e intervistimit**

Në Komisaratin e Policisë Sarandë nga informacioni i dhënë nga drejtuesit e policisë, si dhe nga verifikimet në vend i ambienteve të shoqërimit dhe ato të sigurisë, rezultoi se pranë tyre nuk kishte asnjë zyrë intervistimi për marrjen në pyetje të shtetasve nga punonjësit e policisë. Shtetasit e ndaluar/arrestuar, para se të futeshin në ambientet e sigurisë, intervistoheshin nga oficerët e policisë gjyqësore në zyrat e punës së këtyre të fundit, të cilat nuk ishin të monitoruara me kamera.

Lidhur me këtë fakt, Avokati i Popullit nisur edhe nga inspektimet e mëparshme **ka rekomanduar marrjen e masave për ndërtimin e zyrave të dedikuara ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera pranë tyre, por është konstatuar se sërish ky rekomandim nuk është plotësuar<sup>6</sup>.**

Procesi i monitorimit filmik gjatë marrjes në pyetje të personave të shoqëruar dhe të ndaluar është një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si

---

<sup>5</sup> Kreu VII, pika a.1.4 e Procedurave standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në në mjediset e Policisë së Shtetit”.

<sup>6</sup> “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” Raporti i CPT-së për Armeninë: CPT/Inf (2016) 31 [par.20].

Konsulto:

<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806bf46f>

nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.

Një problematikë e konstatuar nga grupi i inspektimi, kishte të bënte edhe me kohën e vënies në dispozicion të kartës me të drejtat ligjore në formë shkresore personave të shoqëruar apo ndaluar në mjediset e policisë. Aktualisht, personat e shoqëruar/ndaluar nënshkruajnë një deklaratë që vërteton se morën një kopje të fletës me të drejtat e tyre, në përfundim të procesit së marrjes në pyetje në organin e policisë. Por, CPT i ka rekomanduar institucioneve përgjegjëse të policisë të shtetit gjatë inspektimit të kryer në vitin 2018- të, **se personat e shoqëruar/ndaluar duhet të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga fillimi i privimit të lirisë (momenti i shoqërimit)**, duke siguruar informacione të qarta verbale rreth të drejtave ligjore/procedurale që ata kanë që në fillim të privimit të lirisë<sup>7</sup>. Sipas gjetjeve të inspektimit edhe të MKPT, karta me të drejtat e personave të ndaluar u jepej atyre në fund të procesit të marrjes në pyetje dhe jo që në momentin e shoqërimit për në mjediset e komisariatit. Sa më sipër është një praktikë që humbet qëllimin për të cilin parashikohet dhënia e kartës.

Në lidhje me intervistimin/marrjen në pyetje të persona të mitur, sikurse e përmendëm edhe më lart, ishte krijuar një ambient më vete, brenda godinës të komisariatit. Ky ambient përbëhej nga 2 dhoma të ndara më vete, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrimin ulur të të miturve, kujdestarit ligjor dhe avokatit mbrojtës, si dhe me orenditë për punën që kryejnë specialistët e policisë. Stafi i policisë që punonte në “Njësinë për intervistimin e të miturve”, përbëhej nga 2 specialistë policie të cilët ishin trajnuar për këtë qëllim. Nga kontrolli i regjistrave konstatuam se ishin intervistuar 5 të mitur në konflikt me ligjin.

Nga monitorimi që u bë në disa prej zyrave të punonjësve të policisë në godinën aktuale të Komisariatit të Policisë Sarandë, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

### **Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor**

Sipas informacionit dhe nga intervistimi i punonjësit të policisë në zyrën e informacionit, rezultoi se zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde, për plotësimin dhe dhënien çdo personi të shoqëruar, të kopjes së procesverbalit mbi veprimet e kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Nga inspektimi u evidentua se, fashikulli që ndodhej në zyrën e informacionit, përbëhej nga procesverbal tip i emërtuar “Formulari i raportit të Shoqërimit ose Ndalimit/Arrestimit”, si dhe procesverbali i shoqërimit, të plotësuar sipas rubrikave, të cilët ishin të firmosur nga punonjësi i policisë që kishte trajtuar çështjen dhe personi i shoqëruar.

<sup>7</sup> Komiteti Europian për Parandalimin e Torturës ju ka rekomanduar CPT/Inf (2019) 28.



Për personat e ndaluar/arrestuar, zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenet 34/b pika 2 dhe 251 të K.Pr.P., ku thuhet se të ndaluarit/arrestuarit duhet t'i jepet dhe të mbajë me vete një kopje të letrës me të drejtat që gëzojnë këta persona dhe kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit, por momenti i dorëzimit të kartës duhet të ndryshojë.

Lidhur me të drejtën e ligjshme për informim të personave që ndodhen në dhomat e shoqërimit, si dhe në ambientet e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Sarandë, gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e tyre ishin të afishuara posterat me të drejtat e personave të ndaluar/arrestuar, si dhe atyre të shoqëruar. Ndërsa për shtetasit e ndaluar/arrestuar të huaj, u konstatua se punonjësit e zyrës të informacionit dispononin formularë me të drejtat e të ndaluarve/arrestuarve në disa gjuhë të huaja dhe ato ishin pjesë e dokumentacionit që shoqëronin këta persona.

Në takimin që grupi i inspektimit zhvilloi me punonjësit e shërbimit në dhomat e sigurisë, rezultoi se, zbatohet detyrimi ligjor për të informuar personat e ndaluar/arrestuar në moshë madhore se, në mungesë të mundësive financiare për të pajtuar një avokat mbrojtës, mund të kërkojë ndihmë juridike dhe ti ofrohet një Avokat mbrojtës kryesisht nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë, e cila ishte e afishuar në zyrën e përgjegjës të dhomave të sigurisë.

Gjithashtu, në lidhje me trajtimin e personave në momentin që hyjnë në komisarariatet e policisë, sjellim në vëmendje nevojën e verifikimit të gjendjes fizike të personave, për të mënjeluar përgjegjësinë e autoriteteve të policisë, për çështjet e dhunës, sipas rekomandimit edhe të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Dënimit Çnjerëzor ose Poshtëruës (CPT), i cili në raportin për Shqipërinë të botuar në vitin 2019, midis të tjerave ka cituar se: *“Oficerët e policisë duhet të trajtohen që të mos përdorin forcë më shumë sesa është e nevojshme dhe se ajo mund të përdoret vetëm në rast të kapjes së një personi. Pasi ai është arrestuar dhe mbahet nën kontroll, nuk mund të ketë asnjë justifikim për goditjen e tij. Kur vlerësohet e nevojshme të prangoset një person, prangat në asnjë rrethanë nuk duhet të jenë tepër të shtrënguara dhe duhet të mbahen për aq kohë sa është e nevojshme”*<sup>8</sup>.

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht, kujdestarit ligjor dhe të psikologut i cili thirrej nga gjykata pasi që nuk janë pjesë në organikën e Komisarariatit të Policisë Sarandë.

Grupi i inspektimit konstatoi gjithashtu se, vizitat mjekësore e të ndaluarve/arrestuarve nga ana e personelit mjekësor ishin kryer brenda afatit 12 orësh nga koha e vendosjes së tyre në këtë ambient, sikurse përcaktohet në procedurat standarde: “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në

---

<sup>8</sup> CPT ka bërë publik në datën 17.09.2019, raportin mbi vizitat që ka kryer në disa institucione të privimit të lirisë në Shqipëri, nga data 20 deri në datën 30 Nëntor 2018. <https://www.coe.int/en/web/cpt/-/council-of-europe-anti-torture-committee-publishes-report-on-alban-3>

ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.<sup>9</sup> Vizitat mjekësore të të ndaluarve/të arrestuarve kryheshin nga mjeku i Spitalit të Sarandës, pasi Komisariati Policisë Sarandë nuk ka në organikë personel mjekësor. Shënimet me konstatimet, rekomandimet dhe mjekimet e dhëna pasqyroheshin në regjistrin e vizitave mjekësore, si dhe pajiseshin me kartelat mjekësore ditore të tyre.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*”; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ku parashikohet midis të tjerash se: “Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca:*

*b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtëruës.”.*

### **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave të nevojshme në kohë, për ndërtimin e ambienteve të shoqërimit dhe ndalimit, si dhe rikonstruksionin e përgjithshëm të godinës së Komisarariatit të Policisë Sarandë duke respektuar standardet e përcaktuara në ligjin nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, procedurën standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, procedurën standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019.
2. Marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin e ambienteve të reja të sigurisë sipas procedurave standarde: “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1102, datë 07.11. 2017 në Komisariatin e Policisë Sarandë.
3. Marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin në Komisarariatet e Policisë Sarandë të ambienteve të shoqërimit sipas kriterëve të parashikuara në procedurën standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, duke krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orëditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur. Duhet treguar një kujdes i veçantë që projekti të jetë në përputhje me rregullat përkatëse dhe të zbatohet në mënyrë korrekte.

<sup>9</sup> Kreu II, pika 7, procedurave standarde: “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”

4. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin dhomës (zyrës) më vete në ambientin e sigurisë, për marrjen në pyetje të personave të ndaluar/arrestuar, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera.
5. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin të dhomës (zyrës) në ambientin e shoqërimit, për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera.
6. Marrjen e masave të nevojshme për rritjen e higjienës dhe mirëmbajtjen e dhomave të shoqërimit dhe sigurisë deri në rikonstruksionin e plotë të këtyre dhomave.
7. Marrjen e masave të menjëhershme për rishikimin e strukturës/organikës së këtij institucioni dhe veçanërisht me shtimin e mjekut, psikologut dhe juristit.
8. Marrjen e masave të menjëhershme për vendosjen e regjistrit për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar në mjediset e Komisarariatit të Policisë Sarandë.
9. Marrjen e masave për plotësimin me saktësi të regjistrave dhe në veçanti të rubrikës “*Të dhëna për njoftimin e familjarëve/afërmve*” të të shoqëruarit sipas kriterëve të parashikuara në procedurën standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019.
10. Marrjen e masave për të vendosur posterat e rinj me të drejtat dhe kartën e të drejtave të personave që shoqërohen apo ndalohen në ambientet e komisariateve, në vende që të jenë të aksesueshëm nga këta persona.
11. Marrjen e masave të menjëhershme për dhënien e kartës së të drejtave në formë shkrese personave të shoqëruar apo ndaluar në momentin e hyrjes së tyre në komisarariat.
12. Marrjen e masave për krijimin e ambienteve të ajrimit për personat në dhomat e sigurisë.

Për qëndrimin dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONER**

**AHMET PRENÇI**

Konc. & Dakord.:  
G. Çarkaxhiu  
N. Qafzezi